Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0875

Organi Shqyrtues i Prokurimit përmes Panelit Shqyrtues në përbërje të Vjosa Gradinaj Mexhuani si kryetare, Vedat Poterqoi dhe Isa Hasani si anëtar, duke vendosur mbi ankesën e operatorit ekonomik "Astraplan" Sh.P.K. të datës 06.11.2023 si dhe mbi ankesën e operatorit ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. të datës 06.11.2023 kundër Njoftimit mbi Vendimin të datës 19.10.2023 të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "LOT 2 -Vazhdimi i punimeve Akademia e Drejtësisë AD-Prishtinë - Faza II" me numër të prokurimit 214-23-6442-5-1-1, në bazë të nenit 105 lidhur me nenin 106 dhe nenin 117 të LPP, pas shqyrtimit në seancën pa prezencën e palëve me datë 29.01.2024 merr këtë:

Vendim

I. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "Astraplan" Sh.P.K. me nr. 2023/0875 e datës 06.11.2023 ashtu që ANULOHET Njoftimi mbi Vendimin të datës 19.10.2023 të Autoritetit Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull "LOT 2 - Vazhdimi i punimeve Akademia e Drejtësisë AD - Prishtinë - Faza II" me numër të prokurimit 214-23-6442-5-1-1 ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në rivlerësim.

II. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik "EBK" Sh.P.K. me nr. 2023/0876 e datës 06.11.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të dispozitivit.

III. Detyrohet Autoriteti Kontraktues - Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

IV. Lejohet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar ashtu që obligohet operatori ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtroj kërkesë për kthimin e tarifës së asnkesës në përputhje me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

V. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 23.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "LOT 2 - Vazhdimi i punimeve Akademia e Drejtësisë AD - Prishtinë - Faza II" me numër të prokurimit 214-23-6442-5-1-1.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës për punë dhe me vlerë të parashikuar për Lot 2 të kontratës 2,288,173.44€.

Me 19.10.2023, Autoriteti Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin B58 përmes të cilit ka njoftuar anulimin e Lot 2 të aktivitetit të prokurimit.

Me 24.10.2023 operatori ekonomik ankues "Astraplan" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 27.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 06.11.2023 operatori ekonomik ankues "Astraplan" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0875.

Me datë 24.10.2023 operatori ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin B58 e Autoritetit Kontraktues. Rrjedhimisht me datë 27.10.2023 Autoriteti Kontraktues ka marrë vendim përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar këtë kërkesë për rishqyrtim. Me datë 06.11.2023 operatori ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2023/0876.

Gjatë shqyrtimit paraprak të ankesës, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetente për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP.

Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2023/0875 dhe ankesa nr. 2023/0876 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë me seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP e cila u caktua dhe u mbajt me

datën 15.01.2024.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Astraplan" Sh.P.K. janë parashtruar përmes ankesës dhe u deklarun në senacën për dëgjim publik shkurtimisht si në vijim: "ankuesi pretendon se autoriteti kontraktues ka anuluar aktivitetin e prokurimit dhe e ka eliminuar si tenderues duke e shkelur nenet 7, 59, 60, 62, 69, 72 të LPP si dhe kërkesat 9.1 & 9.2 të DT. Autoriteti kontraktues e ka eliminuar ankuesin me arsyetimin se listat e projekteve të prezantuara nuk i përmbushin kërkesat e dosjes së tenderit pasi që vlera e projekteve në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta është 2,231,885.00 euro ndërsa në dosjen e tenderit është kërkuar minimum 3,000,000.00 euro për pjesëmarrësit në të dy lotet. Projektet tjera në listën e ofruar nuk janë sipas dosjes së tenderit por janë projekte në ndërtim të ulët, disa projekte të papërfunduara, disa të natyrës tjetër dhe disa të përfunduara por më të vjetra se tri vite para publikimit të njoftimit për kontratë. Ankuesi pretendon se e plotëson këtë kriter dhe se e tejkalon shumën e kërkuar sipas listave të prezentuara. Po ashtu, ankuesi ka parashtruar pretendime ankimore edhe kundër AC ING Sh.P.K. & TOP Projekt Sh.P.K. duke pretenduar se i njëjti është i papërgjegjshëm për Lot 2 sepse tejkalimi i çmimit është më shumë se 2% dhe se i njëjti është shpallur fitues për Lot 1 prandaj sipas DT nuk mund të shpallet fitues edhe për Lot 2. Ngjashëm, ankuesi ka parashtruar pretendime edhe kundër EBK Sh.P.K. dhe Nika Pro-ing Sh.P.K. duke pretenduar se të njëjtit janë të papërgjegjshëm pasi që nuk plotësojnë kërkesat mbi kapacitetin teknik dhe profesional dhe nuk janë palë me interes në kuptim të nenit 4.1.26 të LPP".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "Astraplan" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 59, 60, 69 dhe 72 të LPP.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. janë parashtruar përmes ankesës dhe u deklarun në senacën për dëgjim publik shkurtimisht si në vijim: "Pika e parë e pretendimeve - Në letrën standarde mbi tenderuesin e eliminuar AK thekson se tenderi ynë nuk e ka plotësuar kërkesën për një inxhinier të diplomuar ose master të ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv, minimumi 5 vjet përvoje pune pas diplomimit në ndërtim të lartë. Ne kemi sqaruar në kërkesën për rishqyrtim se inxhinieri Bardhok Jetshi është pronar i kompanisë UNIVERS - Ml dhe me kompaninë e vet ka kontratë të përhershme të punësimit. Kontrata mes EBK dhe inxhinierit Bardhok Jetishi është ngarkuar gabimisht, si gabim teknik dhe AK mund të shfrytëzoj nenin 72 të LPP për sqarime shtesë. Autoriteti Kontraktues këtë kërkesë tonë e ka cilësuar si të bazuar. Pika e dytë e pretendimeve - Autoriteti kontraktues thekson se per teknikun për BMS me iniciale V.G. nuk është prezentuar marreveshje valide e punës për këtë projekt. AK thekson se kontrata nuk është valide sepse është nënshkruar nga një palë e tretë në emër të teknikut. Në lidhje me këtë pretendim të AK ne e kemi sqaruar në kërkesën për rishqyrtim se ne periudhen kur është dorëzuar tenderi, tekniku V.G. ka qenë në udhëtim jashtë shtetit (në Gjermani) dhe me autorizim nga vet tekniku është nënshkruar kontrata. Nëse tekniku nuk ka qenë fizikisht dhe nëse nënshkrimi do të ishte bërë në emër të V.G. atëherë ne do të kryenim vepër penale të falsifikimit të dokumentit, andaj ne duke pasur konfirmimin verbal nga V.G. se do të jetë në dipozicion për këtë kontratë dhe me lejen e tij kemi nënshkruar në emër të tij. AK duke aplikuar nenin 72 të LPP mund të kërkoj sqarime dhe tekniku V.G. është i gatshëm qoftë me prezencë fizike, qoftë me deklaratë të shkruar të konfirmoj se do të jetë në dispozicion të plotë për realizimin e punëve të BMS për këtë kontratë. Ne zotohemi se inxhinieri B.J. dhe tekniku i BMS V.G. janë në dijeni të plotë të

kushteve të kontratës dhe janë në pajtim të plotë për angazhimin e tyre në këtë procedurë prokurimi".

Duke u referuar te pretendimet si më sipër, operatori ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K. konsideron se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 59, 60, 65, 66 dhe 72 të LPP.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 14.11.2023 ka angazhuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues. Me datë 16.11.2023 është pranuar Raporti i Ekspertit Shqyrtues me rekomandimet si në vijim: "*ankesa të miratohet si pjesërisht e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim*".

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Astraplan" Sh.P.K., ekspertja shqyrtues gjatë seancës dëgjimore sqaroj se në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet lidhur me arsyen e eliminimit të OE ankues sqaron, në ofertën e të njëjtit gjenden tri lista me projekte: GOE: OE Astraplan, OE U-Unique dhe OE Inet SHPK. -6,406,895.58 euro; -704,330.49 euro; -433,080.22 euro si dhe lista e projekteve të OE inet Shpk e cila nuk mund të merret e mirëqenë për arsye të natyrës së projekteve. Në listën e Astraplan gjenden projekte të natyrës ndërtim të lartë, renovim, po ashtu edhe tek lista e anëtarit të konzorciumit U-Unique është e bashkangjitur lista e cila posedon projekte të natyrës ndërtim dhe renovim, kurse anëtari i konzorciumit OE Inet Shpk posedon listën e projekteve me projekte të teknologjisë informative, rrjetave, dhe mirëmabajtje. Mirëpo AK në arsyetimin e eliminimit si dhe në refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, nuk potencon se cilat projekte nuk i plotësojnë kriteret dhe cilat mund ti merren të mirëqenë. Andaj si e tillë pretendimi i OE ankues lidhur me arsyen e eliminimit gjendet pjesërisht i bazuar, e cila gatë procesit të rivlerësimit, kërkohet nga AK që konform nenit 72 të LPP-së të sqaroj listat e projekteve të përfunduara. Tutje, OE ankuesi ka parashtruar pretendime edhe kundër OE AC Ing SHPK, OE EBK SHPK si dhe OE Nika Pro Ing SHPK. Ekspertja Shqyrtuese sqaron, lidhur me OE AC Ing Shpk në ofertë ka të bashkangjitur paramasën për lot 2, e cila është përmirësuar me gabime aritmetikore mbi 2%, dhe si e tillë pretendimi gjendet i bazuar. Ekspertja shqyrtuse sa i përket pretendimit lidhur me OE EBK SHPK sqaron, në e-prokurim gjendet oferta e OE në fjalë, dhe AK ka eliminuar të njëjtin për disa arsye të cilat do ti shqyrtojmë në ankesën e tij të parashtruar me nr. 0876/2023. Kurse lidhur me pretendimet të OE ankuesit të cilat nuk janë të argumentuara dhe të specifikuara konkretisht, nuk mundemi ti shqyrtojmë, si e tillë ky pretendim nuk gjendet i qëndrueshëm. Ekspertja shqyrtuse sa i përket pretendimit lidhur me OE Nika Pro-ing SHPK sqaron, pretendimi i OE ankues nuk qëndron, për faktin se nuk ka parashtruar pretendime konkrete dhe të argumentuara, në mënyrë që ti shtjellojmë".

Kurse lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues "EBK" Sh.P.K., eksperti shqyrtues gjatë seanës dëgjimore sqaroj se në raportin e tij ka paraqitur vlerësimet dhe konstatimet si në vijim: AK në kërkesën për rishqyrtim, OE ankuesit pretendimin e parë ia aprovon si të bazuar dhe si e tillë nuk është e nevojshme ta shqyrtojmë tutje, për faktin se është pretendim i bazuar. Ekspertja shqyrtuese lidhur me pretendimin e dytë sqaron, OE ankuesi në ofertë ka bashkangjitur kontratën për personin në fjalë, mirëpo të nënshkruar nga një person tjetër, për të cilin OE deklaron se ka qenë i autorizuar. Në rastin konkret, OE në ofertë nuk posedon autorizim për personin, mirëpo AK konform nenit 72 të LPP-së mund të kërkoj sqarime se nëse OE posedon autorizimin e noterizuar para datës së hapjes së ofertave".

AK Ministria e Punëve të Brendshme, gjatë senacës dëgjimore thkesoj se qëndroj prapa vendimin për anulimi e ketij aktiviteti të prokurimit ndersa lidhur me Raportit e Ekspertit Shqyrtues me numër **875-876/23**, pohoj se sa i përket Ankesën e dorëzuar nga tenderuesit ankues, Grup i OE **ankues "AstraPlan"SHPK dhe U-UNIQUE SHPK dhe INET SHPK** , për aktivitetin e prokurimit me Titull: "LOT 1 -VAZHDIM I PUNIMEVE "QENDRA PËR VLERËSIM DHE STANDARDE - QVS "- PRISHTINË - Faza II-të dhe LOT 2 -Vazhdimi i punimeve AKADEMIA E DREJTESISE AD - PRISHTINE - Faza II-të", me nr. të Prokurimit: 214-26-6442-5-1-1**,** kundër Njoftimit mbi Vendimin e AK të publikuar me datën 09.10.2023 në platformën elektronike të AK. **nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues**, sepse gjatë vlerësimit të tenderëve të tenderuesve ankues Autoritetin Kontraktues –MPB, ka vepruar në harmoni të plot me LPP-në. Ju për ketë kërkesë ne ofertën e tuaj keni prezantuar listat e projekteve te grupit pjesëmarrës ne ketë tender mirëpo listat te cilat keni prezantuar nuk e përmbush kërkesat e dosjes se tenderi dhe njoftim për kontrate. Ne listën e kontratave te prezantuar nga grupi i juaj pas ekzaminimit shihet se vlera e projekteve në lëmin e ndërtimit të lartë dhe renovimeve të objekteve të larta është 2,231,885.00 € , ndërsa me dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontrate është kërkuar min 3,000,000.00 për pjesëmarrësit ne te dy Lotët. Projekte tjera te prezantuara ne listën tuaj nuk janë siç është kërkuar ne dosje, por janë projekte ne ndërtim te ulet , disa projekte te pa përfunduara dhe disa projekte janë te natyrës tjetër dhe disa projekte janë te përfunduara, por me te vjetra se tri vite para njoftimit për kontrate, si rrjedhoje kjo kërkesë nuk është plotësuar sipas kërkesave ne DT dhe NJK , andaj bazuar ne UDHËZUES Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës se përcaktuar Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm.

Nuk pajtohemi po ashtu as lidhur me trajtimin e Ankesës së parashtruar nga OE EBK, që lënda te kthehet ne rivlerësim për arsye se OE ankues nuk ka dorëzuar dëshmi siç janë kërkuar me dosjen e tenderit. Konkretisht për teknikun e BMS me inicialet V.G ka dorëzuar kontratë te nenshkruar nga një pale e tret e jo nga vet punëmarrësi V.G , gjithashtu pala nuk ka pasur autorizim me shkrim, këtë e ka konfirmuar vete OE ankues ne kërkesën për rishqyrtim citat: Ju sqarojmë se ne periudhën kur është dorëzuar tenderi, tekniku V.G. ka qene ne udhëtim jashtë shtetit, ne Gjermani, dhe me autorizim nga vet tekniku, është nenshkruar kontrata.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive ka vlerësuar të gjitha provat në dispozicion të shkresave të kësaj lënde dhe konsideron se ankesa e GOE "Astraplan" SH.P.K. U-UNIQUE SHPK dhe INET SHPK duhen aprovuar si pjesërisht e bazuara kurse ankesa e OE "EBK" SH.P.K duhet të refuzohet si e pabazuar.

"Astraplan" SH.P.K. U-UNIQUE SHPK dhe INET SHPK, nga cilësia e ti/saj si ankues ka pohuar se e ka plotësuar dhe tejkaluar kriteret e paraparë përkitazi me vlerën si një nga kërkesat specifike të DT, megjithatë AK e kishte refuzuar ofertën e tyre si të papranueshme, gjë që një veprim i tillë bije në kundërshtim me nenin 59 të LPP. Në të vërtetë, krahas materialeve të cilat e karakterizojnë ofertën e ankuesit, po ashtu edhe në raportin ekspertit shqyrtues është konstatuar fakti se në ofertën e ankuesit është bashkangjitur lista e projekteve (përjashtuar listën e prezantuar nga anëtari i konzorciumit INET SHPK si jo e natyrës përkatëse me DT) , në përbërjen e të cilave, gjenden po ashtu projekte të natyrës si ndërtim të lartë, renovim, respektivisht të natyrës së ngjashme të kërkuar nga vet AK, të cilat sipas tij/saj e tejkalojnë

vlerën mbi 6,406,895.58 €.

Në fakt, pas administrimit të listave të prezantuara nga ankuesi në cilësi prove, Paneli vëren se jo të gjitha kontratat e prezantuara e plotësojnë kërkesën e DT, megjithatë duke ju referuar Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe vendimit për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, Paneli vëren se AK nuk e kishte arsyetuar në mënyrën e duhur [si për palët po ashtu edhe për ketë Organ] se cilat kontrata dhe për cilat arsye i kanë dhe/ose nuk i kanë plotësuar sipas tij/saj kriteret e DT. Në të vërtetë, akti përfundimtar i një autoriteti kontraktues nga cilësia e tij si një nga institucionet e administratës publike, duhet domosdo ti plotësoj elementet qenësore të një akti të tillë, sepse kjo kërkohet së paku në kuptim të nenit 115, pa nevojë për ti përshkruar në aspektet përkatëse kërkesat e kësaj dispozite nga paragrafi 1 deri 7 [pa i cituar në ketë dhe kërkesat shprehimore të parashikuar me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative].

Andaj në mungesë të një arsyetimi të duhur, i shoqëruar me argumenteve dhe/ose provave bindëse, Paneli Shqyrtues vlerëson se ky aktivitet duhet të kthehet në rivlerësim, së paku në kuptim të nenit 115, lidhur me nenin 1 dhe 6 të LPP, kurse në procedurën e rivlerësimit, kërkohet nga AK që ti konstatoj se cilat kontrata, për cilat arsye, e plotësojnë apo jo kërkesën e DT. Arsyetimi i mangët ka krijuar si rrjedhojë dhe pretendimet ankimore me ç'rast dhe në seancën e shqyrtimit publik, ankuesi ka pohuar se AK në kundërshtim me nenin 59 të LPP, e kishte refuzuar ofertën e tij/saj pa u komunikuar faktet dhe provat se përse AK nuk e kishte pranuar kontratën e listuar me nr. rendor 25 e prezantuar nga anëtari i konzorciumit U-Unique SHPK titulluar "*Subsidies for Energy Efficiency in Kosovo (SEEK)*" përderisa sipas tij/saj kjo plotësisht i përgjigjej natyrës së aktivitetit. Në fakt, AK ka deklaruar se kontrata e prezantuar si e tillë nuk e plotëson kërkesën e AK ngase e njëjta ka të bëjë vetëm me panele solare dhe rrjedhimisht bie në kundërshtim me natyrën e aktivitetit. Megjithatë bazuar në administrimit e të gjitha provave dhe dëshmive te prezantuara në seancën dëgjimore, përfshirë raportin e ekspertit shqyrtues konsideron se AK duhet ta sqaroj po ashtu këtë kontratë dhe njëherësh si përcaktuese edhe për përgjegjshmërinë e ankuesit, ta analizuar dhe paramasën e kontratave në fjalë, në relacion me kërkesën e vendosur në DT, sikurse kërkohet me nenin 72 të LPP dhe 40 të Rregullores për Prokurimin Publik. Sa i përket pretendimeve tjera, paneli shqyrtues mbështet raportin e ekspertes shqyrtuese pa nevojë që të njëjtat të citohen sërish.

Nga ana tjetër, duke e analizuar ankesën e OE "EBK" SH.P.K. Paneli Shqyrtues vëren se në ofertën e tij/saj nuk është bashkangjitur asnjë autorizim për kryerjen e veprimeve të caktuara juridike të ankuesit në emër dhe llogari të teknikut V.G. përderisa nuk është kontestuese po ashtu se kontrata e teknikut V.G. nuk është nënshkruar nga V.G. por nga një person tjetër në vend të tij. Lidhur me ketë, përfaqësuesi i OE ankues në seancën dëgjimore ka deklaruar se tekniku e kishte autorizimin pranuar vetëm në mënyrë verbale, gjë që sipas gjykimit të pavarur të këtij panelit, AK kishte vepruar drejtë kur kishte eliminuar ankuesin nga ky aktivitet, ngase të njëjtit sipas LPP-së mbajnë përgjegjësi për ofertën e tyre të dorëzuar pranë një autoriteti publik pikërisht në përputhje me të gjitha kërkesat dhe dëshmitë e kërkuara. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet ankimore të ankuesit "EBK" SH.P.K. janë të pabazuara në fakte dhe prova konkret. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues nuk i ka falur besimin konstatimeve në raportin e ekspertit shqyrtues me nr. 2023/0876., e cila kishte rekomanduar që kjo çështje të sqarohet sipas nenit 72 të LPP. Paneli Shqyrtues me këtë rast potencon se kryerja e veprimeve të ndryshme juridike të një personi fizik apo juridik (i autorizuari) në emër dhe llogari të një personi tjetër fizik ose juridik (autorizim dhënësi) është e paraparë dhe rregulluar sidomos me

legjislacionit në fuqi për marrëdhëniet e detyrimeve.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP gjithnjë niset nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore, mirëpo AK duhet të kujdeset edhe për respektimin e parimeve bazë të LPP. Prandaj bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si me sipër.

Apriori, mendimi i një eksperti nuk krijon efekte detyruese për organin vendimmarrës dhe se Paneli shqyrtues [nga cilësia e tij si një autoritet quazi-gjyqësor] shpreh gjithnjë mendimin e pavarur të tij/saj në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 104 të LPP, përderisa vlerat provuese një raporti rezultojnë nga administrimi, shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha fakteve dhe provave përkitazi me veprimet dhe rrjedhën e procesit të prokurimit dhe kërkesat e legjislacionit. Nga ana tjetër, Paneli konsideron se autoritet kontraktuese duhet të ofrojnë shembullin e praktikave të mira dhe në kontekstin e vlerësimit dhe verifikimit të dëshmive të ofruara nga ankuesi në këtë rast si ofertues me çmim më të ulët në harmoni me nenin 6,7, 52.7,59,60,69 dhe 72 të LPP, po ashtu të sigurojnë që fondet publike do të përdorën në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marr në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit ashtu siç parashihen në paragrafët përkatës të nenit 1 të LPP.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I, II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 4 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën V të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 5 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vjosa Gradinaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **Astraplan SH.P.K., EBK SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: